

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R.K., nga Gj., për shkak të veprave penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPK-së dhe veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. Y.H., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.1/2016 datë 16 janar 2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.138/2017 datë 18.4.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8 maj 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit R.K., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.1/2016 datë 16 janar 2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.138/2017 datë 18.4.2017.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.1/2016 datë 16 janar 2017, i dënuari R.K. është shpallur fajtor për veprat penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPK-së dhe veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 17.11.2015 deri më 22.2.2016 dhe arrest shtëpiak nga data 22.2.2016 deri më datë 8.6.2016. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil ndërsa i dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 €, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.138/2017 e datës 18.4.2017, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit kurse aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Y.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPK-së si dhe nenin 261 par.1 të KPK-së, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim si dhe ndaj të dënuarit të ndërpritet ekzekutimi i aktgjyimit të formës së prerë e deri në vendosje sipas kërkesës.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.178/2017 e datës 21.9.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, meqë në aktgjykime nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet të cilat këto gjykata i kanë konsideruar si të vërtetuara kur i dënuari është shpallur fajtor dhe gjykuar. Kështu, mbrojtja konsideron se me aktgjykimin e shkallës së parë, respektivisht në dispozitiv të këtij aktgjykimi, thuhet se “kanë përpiluar dhe me dije kanë përdorur dokumente të falsifikuara , dhe atë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në atë mënyrë që edhe pse kanë qenë në dijeni se personi R.V., kishte vdekur”, edhe pse në shkresat e çështjes nuk ka asnjë dëshmi me të cilën vërtetohet se personi R.V. kishte vdekur. Në fakt në shkresa gjendet certifikata e vdekjes e datës 24 shtator 2013, nga e cila vërtetohet se personi R1.V1. ka vdekur më 13 mars 2002, që do të thotë se personi me emrin R.V. nuk është personi i njëjtë. Më tutje, të dënuarit i vihet në barrë se “në vend të numrit personal real të letërnjoftimit të të ndjerit ... shënojnë numrin e rrejshëm” edhe pse në fakt në kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë është shënuar numri personal i R.V. dhe është përshkruar ditëlindja dhe numri identifikues i të njëjtit, pra jo i R1.V1. që edhe është tjetër person. Po ashtu, në kërkesë pretendohet se kontratën mbi shitblerjen e ka nënshkruar personalisht

shitësi R.V. i cili është identifikuar përmes letërnjoftimit, kopjen e të cilit e ka ndalur në shkresat e lëndës zyrtari i gjykatës i cili bënë vërtetimin e kontratave, pra identiteti i tij është vërtetuar dhe nuk mund të jetë se e ka nënshkruar dikush tjetër, kur në fakt kontratën e ka nënshkruar pronari i vërtetë, ndërsa të dy gjykatat kanë dështuar ta vërtetojnë se personi i paraqitur në emër të shitësit personi R.V. a ka qenë vërtetë pronar i këtyre ngastrave dhe a është vërtetuar identiteti i tij në bazë të dokumentit dhe a ka qenë ai dokument origjinal apo si i tillë i falsifikuar sepse largimi i këtij dokumenti nga shkresat e lëndës ka lënë gjithçka pezull. Fakti se kontrata mbi shitblerjen ka qenë e përpiluar vetën në gjuhën shqipe, nuk mund të jetë bazë për të nxjerrë një përfundim se kontrata është e falsifikuar, për faktin se gjuha shqipe është gjuhë zyrtare e Republikës së Kosovës dhe ka qenë obligim i zyrtarit për vërtetimin e kontratave që paraprakisht të bindet se pala a e kupton përmbajtjen e kontratës dhe a ka vërejtje në këtë. Sa i përket shkeljeve të ligjit penal mbrojtja konsideron se në veprimet e të dënuarit nuk janë përmbushur disa kushte për kualifikimin e veprës penale për të cilën është shpallë fajtor dhe atë ngase nga shkresat e lëndës nuk mund të nxirret një përfundim se letërnjoftimi i personit R.V. ka qenë i falsifikuar ngase i njëjti nuk ndodhet fare në shkresa dhe asnjëherë nuk është administruar, ndërkaq sa i përket veprës së mashtrimit nga neni 261 par.1 të KPK-së, po ashtu është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit me që mbrojtja konsideron se nuk është konsumuar asnjë element i kësaj vepre penale sepse nuk kemi të bëjmë as me tregimin e rrejshëm të fakteve e as me fshehjen e fakteve e pa këto elemente qenësore nuk mund të ekzistojë vepra penale e mashtrimit. Në rastin konkret mbrojtja konsideron se kemi të bëjmë me një raport civilo-juridik, me që i dënuari nuk ka paraqitur asnjë fakt të rrejshëm. Ngastrat kadastrale që kanë qenë objekt i shitblerjes kanë qenë të evidentuara në emër të tij, janë shitur me çmim të tregut, gjithnjë duke menduar se prona kontestuese është blerë nga pronari i vërtetë dhe kontratën mbi shitblerjen e ka ekzekutuar në organin kompetent.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar këto pretendime si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjes, gjen se aktgjykimet janë përpiluar konform nenit 370 të KPPK-së, dhe se janë paraqitur arsyet për të gjitha faktet dhe për çfarë arsye janë konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsye për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke ndërlidhur njërin me tjetrën dhe kështu si jokontestuese dalin faktet se i dënuari R., ka qenë i interesuar të marrë një parcelë dhe ka dëgjuar se në fshatin M.të E., komuna e N., është një pronë prej 7-8 ha, pronë e tani të ndjerit R.V., i cili është quajtur me tre emra, R., R1. dhe R2., dhe se emri i babait të tij ka qenë D. Të gjitha këto vërtetohen nga deklaratat e këtu të dëmtuarve, fëmijëve të tij S.V., B.V., R.V. etj., të cilët edhe kanë sjellë certifikatën e vdekjes në emër të R1.V1., nga e cila vërtetohet se më datë 13.3.2002, ka ndërruar jetë dhe se i njëjti ka jetuar deri në vitin 1999 në fshatin M.të E. dhe pas luftës në Kosovë është larguar, ndërkaq në fshat ka mbetur të jetojë njëri prej

djemve të tij, konkretisht B.V., i cili ka punuar si mësues dhe ka vërtetuar se babai i tij ka lënë një pasuri prej 8 ha dhe për tjetërsimin e kësaj ka kuptuar kur e ka kërkuar fletën poseduese dhe ka vërejtur se pasuria e babait të tij nuk është në emër të tij. Po ashtu dëshmitarët të cilët janë dëgjuar kanë deklaruar se prona e cila ka qenë në emër të tani të ndjerit R.V., nuk është shitur asnjëherë dhe askush nuk ka qenë i autorizuar për ta bërë këtë. Nga shkresat e çështjes po ashtu nuk është kontestuese se i dënuari R.K., së bashku me të akuzuarin F.R., procedura penale për të cilin është veçuar, janë takuar dhe i akuzuari F., i ka treguar se e njeh pronarin e parcelës kontestuese -R.V. dhe se mund ta sjellë sepse edhe ai është i interesuar që ta shet pronën e tij. Nga shkresat e çështjes është vërtetuar se i dënuari R., ka lidhë kontratë mbi shitblerjen në shumë prej 9.800 € për 7 ha e 16 ari dhe se kontrata ka qenë e përpiluar vetëm në gjuhën shqipe edhe pse shitësi – R.V. ka qenë i nacionalitetit serb dhe se kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, ndërsa nga shkresat e çështjes vërtetohet se R.V. i cili është paraqitur si pronar, ka vdekur më 13.3.2002, ndërsa ka lindur më datë 10.8.1915 që i bie që në momentin kur është bërë shitja e ngastrës kontestuese i njëjti të jetë i moshës 97 vjeçare, ndërkaq nga vet deklarata e të dënuarit vërtetohet se shitësi përshkruhet si person me trup të shkurtë, i plotë, diku i moshës 70 vjeçare dhe se të njëjtin më nuk e ka takuar asnjëherë ndërkaq paratë e blera janë dhënë në dorë pa transferim bankar.

Pretendimi se nuk është vërtetuar fakti se R.V., ka vdekur nuk qëndron sepse nga shkresat vërtetohet se R1.V1., ka vdekur dhe se i njëjti është prindi i dëshmitarëve të cilët edhe kanë iniciuar procedurën pasi që kanë gjetur se pasuria e tij është shitur dhe atë personit R.K. Është e vërtet se në shkresa bëhet fjalë për personin me tre emra R., R1. dhe R2, por nga deklaratat e dëshmitarëve konkludohet se kemi të bëjmë me të njëjtin person i cili ka vdekur më 13.3.2002, ndërsa ka lindur më datë 10.8.1915, dhe i cili është babai i dëshmitarëve. Fakti se në shkresa nuk gjendet kopja e letërnjoftimit të personit i cili e ka nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe fakti se kopjen e ka kërkuar i dënuari dhe atë menjëherë pasi që është nënshkruar kontrata, përkundrazi, e vërteton faktin se i dënuari ka qenë në dijeni se nuk kemi të bëjmë me pronarin e vërtetë. Po ashtu fakti se ngastra prej 7 ha e 16 ari është shitur për çmim prej 9800 €, vërteton se kjo është bërë me qëllim që ti iket transferimit bankar të mjeteve kur dihet se për shuma deri në 10.000 € nuk duhet të bëhet transferim bankar, sikur edhe fakti se kontrata është përpiluar vetëm në gjuhën shqipe edhe pse “shitësi” ka qenë i nacionalitetit serb. Fakti se personi i cili ka nënshkruar kontratën dhe se identiteti i tij është vërtetuar nga dokumenti identifikues nuk e ndryshon faktin se i dënuari e ka ditur se kemi të bëjmë me person i cili nuk është pronari i vërtetë, sepse zyrtari i cili bënë vërtetimin e kontratës vetëm e vërteton se a i përgjigjet personi para tij dokumentit identifikues të paraqitur, ndërsa i dënuari ka qenë në dijeni se kemi të bëjmë me person tjetër, e mu nga arsyet që u thanë më lartë.

Të gjitha këto fakte jokontestuese e së bashku edhe me provat tjera, për të cilat janë dhënë arsyet ligjore nga gjykata e shkallë së parë dhe të cilat arsye janë pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë ,bëjnë që të vërtetohet se i dënuari ka qenë në dijeni të plotë se pronari i vërtetë ka vdekur dhe se së bashku me të akuzuarin F.R., kanë përgatitur dhe kanë bërë të mundur shitblerjen e patundshmërive duke e paraqitur personin R.V. si pronarin e vërtetë, dhe pasi që ka arritur të bëjë ndryshimin në librat kadastral në emër të tij, këtë pronë ia ka shitur personave tjerë duke qenë në dijeni se nuk është pronar i vërtetë pra duke i mashtruar të njëjtit. Të gjitha këto bëjnë që në këto rrethana drejtë ka vepruar gjykata e shkallë së parë kur të dënuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPK-së dhe veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së.

Nga këto që u tha kjo gjykatë gjen se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet qenësorë të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor me çka pretendimet se është shkelur ligji penal në dëm të njëjtit i bënë të paqëndrueshme.

Nga të gjitha këto u konkludua se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen e as që ndaj të dënuarit është shkelur ligji penal .

Duke marrë parasysh se ndaj të dënuarit nuk është shkelur ligji penal në dëm të tij dhe se kjo gjykatë nuk ka gjetur shkelje tjera e në bazë të nenit 437 të KPPK, kjo gjykatë ka konsideruar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar dhe ka vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.256/2017, më 8 maj 2018

Procesmbajtës,  
Bujar Bala

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta